



Ma 4004/1 prot
H: 15.06.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 43211
prot.

Shkodër, më 09.06.2026

LËNDA: Mbi vendimin Nr.35 datë 28.05.2026 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejes.

KËSHILLIT TË BASHKISË VAU-DEJES.

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji Nr.107/2016 dt.2.10.2016 "Për Prefektin" i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit Nr.21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", Urdhërit të MB Nr.39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, neni 9 pika 1.5, germa a, neni 54, pika dh, neni 55 pika 3, neni 64, shkronja "c", ligjit Nr. 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", i ndryshuar, ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën me Shqipërisë" i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrise së Financave dhe Ekonomisë Nr.9 date.20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", VKB Vau-Dejes Nr.74 datë. 23.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vau-Dejes të vitit 2026 dhe programit buxhetore afatmesëm perfundimtare 2026-2028 të Bashkisë Vau-Dejes", Dokumentacionit të dërguar nga Sekretari Këshillit Bashkiak Vau-Dejes Nr.3793prot datë.21.05.2026, Shqyrtoi **VKB Vau-Dejes nr.35 datë 28.05.2026** "Mbi shtesën e buxhetit të Bashkisë Vau-Dejës, prej 5.000.000 lekësh, VKB-së Vau-Dejës Nr.74 datë. 23.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vau-Dejes të vitit 2026", sipas Akt-Marëveshjes nr.3016.prot datë.15.04.2026, Ndërmjet Këshillit të Qarkut Shkodër dhe Bashkisë Vau-Dejës".

Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Holta DUDA



**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK****VENDIM**Nr. 35, datë 28.05.2026**“PËR SHITESËN E BUXHETIT TË BASHKISË VAU DEJËS, VKB-në NR 74 DATË 23.12.2025”. SIPAS AKT MARRËVESHJES NR.3016 PROT DATË 15.04.2026 NDËRMJET KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR DHE BASHKISË VAU DEJËS.**

Mbështetur në nenin 9 pika” 1.3, nenet 34-37, 40, 41, 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-30, kreu VI neni 2, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore”; neni 44 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Ligjin 87/2025 “Per buxhetin e vitit 2026”, Udhëzimin Plotësues nr 2 datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026, VKB-ne nr 74 datë 23.12.2025 “Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2026 – 2028, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës” , dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 884/1 prot datë 07.01.2026, , **Sipas Akt Marreveshjes nr 3016 Prot date 15.04.2026 “Për Bashkepunim ndërvendor në fushën e Shërbimeve Publike për kryerjen e investimit “Rikonstruksion i godinës së qendrës sociale “Besa” ,Barbullush (Nyjet hidrosanitare)+Mbikqyrje+Kolaudim - Bashkia Vau Dejës”, të lidhur mes Këshillit Shkodër përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit z.Edmond Ndou dhe Bashkisë Vau Dejës përfaqësuar nga Kryetari z. Kristian Shkreli dhe Vendimit të Qarkut Shkoder nr 5 date 27.03.2026 “Mbi disa ndryshime në VKQ nr 27 datë 23.12.2025”Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026 dhe PBA perfundimtar 2026-2028, dhe relacionit të administratës së bashkisë, Këshilli Bashkiak:**

V E N D O S I:

1.Miratimin e shpërndarjes së shtesës së Buxhetit të Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë:

a)Miratimin e shpërndarjes së shtesës së buxhetit të bashkisë, të parashikuar sipas programeve buxhetore, për vitin 2026, të ndara sipas tabelës nr 1, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.

b)Fondet buxhetore do kalojnë në programin buxhetor 10430 “Përkujdesja Sociale” për financimin e projektit: “Rikonstruksion i godinës së qendrës sociale Besa ,Barbullush (Nyjet hidrosanitare) +Mbikqyrje+Kolaudim -Bashkia Vau Dejës”, në vlerën 5,000,000 lekë, Llog.Ekonomike 231-Shpenzime kapitale të trupëzuara ,instistucioni Bashkia Vau Dejës, sipas tabelës Nr.1 së bashkëlidhur këtij projekt vendimi.

c)Miratimin e rishpërndarjes së cash-it në vlerën prej 5,000,000 lekësh , sipas tabelës nr 2, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.



2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"), ndryshuar).



KRYETAR KËSHILLI

Ervis Shimaj

SEKRETAR KËSHILLI

Ardian Çelepija

Miratuar me 16 vota

Vota Pro 16

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02.06 2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KRYETAR

PROJEKT-VENDIM

Nr. 9, datë 20.05.2026

PËR

“SHITESËN E BUXHETIT TË BASHKISË VAU DEJËS,
VKB-në NR 74 DATË 23.12.2025”.

**SIPAS AKT MARRËVESHJES NR.3016 PROT DATË 15.04.2026 NDËRMJET
KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR DHE BASHKISË VAU DEJËS.**

Mbështetur në nenin 9 pika” 1.3, nenet 34-37, 40, 41, 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar ; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-30, kreu VI neni 2, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; neni 44 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Ligjin 87/2025 “Per buxhetin e vitit 2026”, Udhëzimin Plotësues nr 2 datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026, VKB-ne nr 74 datë 23.12.2025 “Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2026 – 2028, numrin e punonjësvë të Bashkisë Vau Dejës” , dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 884/1 prot datë 07.01.2026, , **Sipas Akt Marreveshjes nr 3016 Prot date 15.04.2026 “Për Bashkepunim ndërvendor në fushën e Shërbimeve Publike për kryerjen e investimit “Rikonstrukcion i godinës së qendres sociale “Besa” ,Barbullush (Nyjet hidrosanitare)+Mbikqyrje+Kolaudim - Bashkia Vau Dejes”, të lidhur mes Këshillit Shkodër përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit z.Edmond Ndou dhe Bashkisë Vau Dejës përfaqësuar nga Kryetari z. Kristian Shkreli dhe Vendimit të Qarkut Shkoder nr 5 date 27.03.2026 “Mbi disa ndryshime në VKQ nr 27 datë 23.12.2025”Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026 dhe PBA përfundimtar 2026-2028, dhe relacionit të administratës së bashkisë, Këshilli Bashkiak:**

V E N D O S I:

1. Të miratojë shpërndarjen e shtesës së Buxhetit të Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë:

- a) Të miratojë shpërndarjen e shtesës së buxhetit të bashkisë, të parashikuar sipas programeve buxhetore, për vitin 2026, të ndara sipas tabelës nr 1, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.
 - b) Fondet buxhetore do kalojnë në programin buxhetor **10430 "Përkujdesja Sociale" për financimin e projektit: "Rikonstruksion i godinës së qendrës sociale Besa ,Barbullush (Nyjet hidrosanitare) +Mbikqyrje+Kolaudim -Bashkia Vau Dejës", në vlerën 5,000,000 lekë, Llog.Ekonomike 231- Shpenzime kapitale të trupëzuara ,instistucioni Bashkia Vau Dejës, sipas tabelës Nr.1 së bashkëlidhur këtij projekt vendimi.**
 - c) Të miratojë rishpërndarjen e cash-it në vlerën prej **5,000,000 lekësh** , sipas tabelës nr 2, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
 3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kristian SHKRELI



Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Ebe Rulle

Drejtoria Juridike e Integritimit Prokurimeve dhe Aseteve

Marjeta Deda

Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike

Ana Shumka

Institucioni: Bashkia Vau Dejës

Tabela Nr 1: " Shtese e buxhetit të njesise së veteqeverisjes vendore për vitin 2026"

Sipas Akt Marreveshjes nr 3016 date 15.04.2026 "Per Bashkepunim ndërvendor në fushen e Shërbimeve Publike për kryerjen e investimit "Rikonstrukcion i godinës së qendrës sociale Besa,Barbullush (Nyjjet hidrosanitare) +Mbikqyrje+Kolaudim- Bashkia Vau Dejës ", dhe Vendimit të Qarkut Shkodër nr 5 date 27.03.2026.

SHTOHET

Në Lekë

Entit.i Qev. Linjes	Min.e Kod Instit.	Kod Institucioni	Emër	Kap.	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti 2026	Emërtimi i Projektit
157.00	2157001	Dejes	Bashkia Vau-	05	10430	2310000	3333	1570885	5,000,000.00	Rikonstrukcion i godinës së qendrës sociale Besa, Barbullush (Nyjjet hidrosanitare) +Mbikqyrje+Kolaudim
SHUMA TOTALE										
									5,000,000.00	

Nëpunësi Zbatues

Elsa Tanushi

Nëpunësi Autorizues

Kryetar
Kristian Shkreli



INSTITUCIONI: BASHKIA VAU DEJËS

Tabela Nr.2: Rishpërndarje CASH-I

PAKËSOHET

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Kap.	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Debiti	Emër Institucioni
157 00		2157001 05		6999999	3333	5,000,000.00	Bashkia Vau-Dejes
TOTALI KAP 05						5,000,000.00	

SHTOHET

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Kap.	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Debiti	Emër Institucioni
157 00		2157001 05		2319999	3333	5,000,000.00	Bashkia Vau-Dejes
TOTALI KAP 05						5,000,000.00	

Nëpunësi Zbatues

Elsa Tanushi

Nëpunësi Autorizues
Kryetar

Kristian Shkreli



RELACION

PËR

PROJEKT VENDIMIN

PËR

“SHITESËN E BUXHETIT TË BASHKISË VAU DEJËS,
VKB-në NR 74 DATË 23.12.2025”.

SIPAS AKT MARRËVESHJES NR.3016 DATË 15.04.2026

NDËRMJET KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR DHE BASHKISË VAU DEJËS.

QËLLIMI I PROJEKTIVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projekt vendim ka për qëllim shtesën e buxhetit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr 74 datë 23.12.2025 ‘Miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2026 – 2028, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës’, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 884/1 prot datë 07.01.2026.

Me zbatimin e buxhetit të vitit 2026 ka lindur nevoja për shtesën e buxhetit të bashkisë për arsye të Akt Marreveshjes nr 3016 Prot date 15.04.2026 “Për Bashkepunim ndërvendor në fushen e Shërbimeve Publike për kryerjen e investimit "Rikonstruksion i godinës së qendrës sociale ,Besa, Barbullush (Nyjet hidrosanitare)+Mbikqyrje+Kolaudim –Bashkia Vau Dejës ”, të lidhur mes Këshillit Shkodër përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut z.Edmond Ndou dhe Bashkisë Vau Dejës përfaqësuar nga Kryetari z. Kristian Shkreli, e cila është lidhur për mënyrën e lëvrimin të fondeve në të cilën sipas nenit 3 të akt marrëveshjes “Qarku në një kohë sa më të parë me fondet e planifikuara të vitit 2026 dhe përkatësisht shuma prej 5,000,000 (pesëmilion) lekë, bën menjëherë transferimin e kësaj shume tek Bashkia, për kryerjen e investimit me objekt : “Rikonstruksion i godinës së qendrës sociale “Besa” , Barbullush (Nyjet hidrosanitare)+Mbikqyrje+Kolaudim - Bashkia Vau Dejës”. Qarku ka kryer procedurën e transferimit të fondeve sipas pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.5 datë 27.03.2026.

Ky Projekt Vendim është bazuar dhe në Vendimin e Qarkut Shkodër nr 5 date 27.03.2026 “Mbi disa Ndryshime ne VKQ nr 27 datë 23.12.2025” Mbi miratimin ne buxhetin e Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026 dhe PBA perfundimtar 2026-2028, sipas nenit 2 “Të miratohet transferimi i fondit të planifikuar në buxhetin 2026 për investimin “Rikonstruksion i qendrës sociale “Besa” , Barbullush (Nyjet hidrosanitare))+Mbikqyrje+Kolaudim - Bashkia Vau Dejës ,në shumën prej 5,000,000 lekësh , nga Këshilli i Qarkut në Bashkinë Vau Dejës. Ky fond është arkëtuar nga Bashkia Vau Dejës gjatë muajit Prill 2026 dhe me anë të këtij projekt vendimi do shkojë në rrijtje të këtij investim .

Prandaj buxheti i bashkisë miratuar sipas VKB nr 74 datë 23.12.2025 “Miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2026 – 2028, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës” dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr

884/1 prot datë 07.01.2026, shtohet me vlerën prej 5,000,000 (pesë milion) lekësh, zërit të investimit "Rikonstruksion i godinës së qëndres sociale "Besa" ,Barbullush (Nyjet hidrosanitare) +Mbikqyrje+Kolaudim -Bashkia Vau Dejës", në programin 10430 me kod produkti 1570885.

VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028, DHE ME BUXHETIN E VITIT 2026.

Projekt Vendimi është parashikuar duke u bazuar në politikat dhe strategjinë e programit të PBA-së 2026-2028 dhe me Buxhetin e Vitit 2026.

I. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përparësia e këtij projektvendimi është përmirësimi i shërbimit të ofruar nëpërmjet planifikimit dhe buxhetimit eficient dhe i mirë-analizuar i shpenzimeve publike me synim rritjen e efektivitetit dhe përdorimit ekonomik të fondeve publike

- Menaxhimi efektiv i të ardhurave vendore si një mënyrë e rëndësishme për të rritur investimet dhe në interesin publik;
- Rritje e cilësisë së infrastrukturës në territorin e bashkisë;
- Konsolidimi i shërbimeve publike;
- Nxitje e zhvillimit ekonomik për bizneset;
- Ndërtimi i infrastrukturës moderne: Infrastruktura rrugore

Këto ndryshime do të bëjnë të mundur përmirësimin e fushave kryesore aktuale, duke rregulluar balancat, rritur shërbimin dhe duke rritur funksionin që ka bashkia për sektorë të ndryshëm në territorin e saj

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është në harmoni të plotë me:

1. Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar,
2. Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore, i ndryshuar
3. Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar,
4. Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar;
5. Ligji 87/2026 "Për buxhetin e vitit 2026",
6. Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"
7. Vendim i Këshillit Bashkiak nr 74 prot me datë 23.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës, të miratuar me shprehje ligjshëmërie nga Prefektura Shkodër me nr 884/1 prot dhe datë 07.01.2026.

8. Udhëzim plotësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit 2026".
9. Vendimin e Qarkut Shkodër nr 5 date 27.03.2026 "Mbi disa Ndryshime ne VKQ nr 27 datë 23.12.2025 "Mbi miratimin në buxhetin e Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026 dhe PBA 2026-2028.
10. Akt Marreveshjes nr 3016 date 15.04.2026 "Për Bashkëpunim ndërvendor në fushën e Sherbimeve Publike për kryerjen e investimit "Rikonstruksion i godinës së qendrës sociale "Besa" Barbullush (Nyjet hidrosanitare)+Mbikqyrje+Kolaudim", Bashkia Vau Dejës, të lidhur mes Këshillit Shkodër përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut z.Edmond Ndou dhe Bashkisë Vau Dejës përfaqësuar nga Kryetari z. Kristian Shkreli

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Mbi domosdoshmërinë e investimeve të shtuara

Sektori i Investimeve Publike mendon të shtojë realizimin e objekteve për vitin 2026

1. "Rikonstruksion i godinës së Qendrës Sociale "Besa" , Barbullush (Nyjet hidrosanitare)" +Mbikqyrje+Kolaudim - Bashkia Vau Dejës

Përgjegjës i Investimeve dhe Projekteve Publike
Indrit Kurtbegu

Drejtorja Juridike e Integrimit Prokurimeve dhe Aseteve
Marinela Deda

Përgjegjës i Buxhetit dhe Financës
Armena Zagani

Drejtorja Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar
Drejtor
Elsa Tanushi

KRYETAR

Kristian Shkreli





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA VAU DEJËS

Nr. 3016 Prot., me 15.04.2026



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT SHKODËR

Nr. 275 Prot., me 15.04.2026

AKT – MARREVESHJE

Për

“ Bashkëpunim ndërvendor në fushën e Shërbimeve Publike për kryerjen e investimit “Rikostruksion i godinës së qendres sociale “Besa”, Barbullush - Bashkia Vau Dejës”

e lidhur mes

Këshilli i Qarkut Shkodër, përfaqësuar nga Kryetari Z. Edmond NDOU që në vijim të dispozitave të kësaj Akt-Marrëveshjeje, do të quhet “Qarku”

Dhe

Bashkia Vau Dejës përfaqësuar nga Kryetari Z. Kristian SHKRELI, që në vijim të dispozitave të kësaj Akt-Marrëveshjeje, do të quhet “Bashkia”.

Baza ligjore:

- Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 14; neni 31 pika 2; neni 64 pika gj; neni 77 pika m; neni 83 pika 1.
- Ligji nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”.
- VKQ Shkoder nr.24,date 23.12.2025 ”Mbi disa ndryshime mbi prioritetet e Këshillit të Qarkut Shkodër”.
- VKQ Shkoder nr.27,date 23.12.2025 ”Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026 dhe PBA 2026-2028”.
- Shprehja Ligjore Nr.866/1 Prot. Datë 08.01.2026.
- VKQ Shkoder nr. 05 ,date 27.03.2026 ”Mbi disa ndryshime në VKQ nr.27 datë 23.12.2025 ”Mbi miratimin buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026 dhe PBA 2026-2028”.

Lidhet kjo Akt-Marrveshje, për bashkëpunim ndërvendor, si më poshtë;

Neni 1

Objekti i Akt-Marrëveshjes:

1. Objekt i kësaj Akt-Marrëveshjeje, është bashkëpunimi ndërvendor ne fushën e Shërbimeve Publike, për kryerjen e investimit **“Rikostruksion i godinës së qendres sociale “Besa”, Barbullush -**



Bashkia Vau Dejës, nga "Qarku", në zbatim të Vendimit të Këshillit të Qarkut Shkodër dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës, ku përcaktohet si prioritet realizimi i këtij investimi.



Neni 2

Kushtet e marrëveshjes

1. "Qarku" merr përsipër të financojë projektin e Bashkisë Vau Dejës, në shumën totale 5,000,000 (Pesë milion) lekë me tvsh, sipas Preventivit të parashikuar.
2. Qarku do të kryejë transferimin e fondeve të planifikuara dhe të miratuara në buxhetin e vitit 2026, nga Këshilli i Qarkut Shkodër tek Bashkia Vau Dejës për kryerjen e investimit për objektin "Rikonstruksion i godinës së qendres sociale "Besa", Barbullush - Bashkia Vau Dejës", në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi për këtë qëllim.
3. Afati i akt-marrëveshjes përfundon me kryerjen e investimit për të cilin Qarku do të vihet në dijeni.

Neni 3

Mënyra e lëvrimit të fondit/Burimi i Financimit

1. Qarku, në një kohë sa më të parë me fondet e planifikuara të vitit 2026 dhe përkatsisht shuma prej 5,000,000 (Pesë milion) lekë me tvsh, bën menjëherë transferimin e kësaj shume nga Qarku tek Bashkia, për kryerjen e investimit me objekt "Rikonstruksion i godinës së qendres sociale "Besa", Barbullush - Bashkia Vau Dejës".
2. Qarku, do kryejë procedurën e transferimit të fondeve sipas pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.05 date 27.03.2026.

Neni 4

Detyrimet e palëve

1. Qarku, në bazë të projektit të investimit "Rikonstruksion i godinës së qendres sociale "Besa", Barbullush - Bashkia Vau Dejës" dhe vendimit të KQShkodër, do të kryejë transferimin e fondit për këtë investim.
2. Bashkia detyrohet të kryejë procedurat e prokurimit për këtë investim dhe ta përdorë shumën e transferuar nga Qarku, vetëm për investimin e planifikuar dhe të miratuar, sipas kësaj Akt-Marrëveshje në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 5

Detyrimi për raportim

1. Bashkia, detyrohet të respektojë kushtet e kësaj Akt-Marrëveshje duke ju referuar objektit të saj si dhe të njoftojë Qarkun për ecurinë e kryerjes së këtij investimi. Për këtë mban përgjegjësi struktura



përgjegjëse e kryerjes së procedurave të Prokurimit pranë Bashkisë Vau Dejës, cila do të informojë Qarkun për ecurinë e procedurave të prokurimit e deri në fazën e marrjes në dorëzim të investimit.

Neni 6

Dispozita të Përgjithshme

1. Në rast mosmarrëveshesh që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet palëve, pala e interesuar do t'i drejtohet gjykatës kompetente.
2. Kjo marrëveshje përbëhet nga 3 fletë dhe hartohet në 4 kopje origjinale, 2 kopje do të mbahen nga Qarku, ndërsa 2 kopje të tjera do t'i jepen Bashkisë.
3. Palët pasi e lexuan, e pranuan pa vërejtje dhe e nënshkruan me vullnetin e tyre të plotë.

Për Bashkinë

KRYETARI

Kristian SHKRELI



Për Qarkun

KRYETARI

Edmond NDOU

